



Nr.903/05-2012

Gjykata themelore-Departamenti i përgjithshëm-Divizioni për kundërvajtje në Prizren, me gjyqtarin Alija Fazlji, në procedurën e kundërvajtjes kundër pandehurit Sencar Karamuço nga Prizreni, për shkak të kundërvajtjes nga nen. 9 dhe 15 par.3 e dënueshme sipas nen.17 par.1.pik.5 të Ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë zyrtarëve të lart publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për të gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050), e në bazë të nen.195 Ligjit mbi kundërvajtjet, më 27.11.2013, morri

AKTVENDIM

I pandehuri Sencar Karamuço, nga babai Fevzi, i lindur më 21.05.1983 në Prizren, me banesë në rr.Alajdin Berisha,nr. 27, drejtor në Drejtoratin për raste urgjente dhe sigurim pranë KK Prizren.

Ë s h t ë P ë r g j e g j ë s

Sepese në afatin ligjor prej 15 ditëve nga dita e pranimit të njoftimit (deri më 28.09.2012), si nëpunësi i lartë shtetëror publik, Agjencionit kundër korrupsionit, nuk dorëzoi më vonë formularin e plotësuar mbi deklarimin e pasurisë.

- me çka ka kryer kundërvajtje nga nen. 9 dhe 15 par.3 e dënueshme sipas nen.17 par.1.pik.5 të Ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollin e pasurisë zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollin e dhuratave për gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050), dhe për këtë me zbatimin e nen.9. par.1.pik.1.të Ligjit mbi kundërvajtjet

D Ë N O H E T

ME GJOBË NË TË HOLLA në shumë prej 250 (dyqindpesëdhjet) €.

I pandehuri detyrohet që dënimin e shqiptuar me gjobë të pagoi në afat prej 15 ditëve me plotfuqishmërin e aktvendimit, në të kundërtën shqiptimi i dënimit me gjobë do të zëvendësohet me dënimin me burg ashtu që për çdo 20 € dënimin me gjobë caktohet një ditë burg. E pandehura detyrohet që në afatin e njëjtë të pagoi shpenzimet e procedurës në shumën paushalle prej 5 €, nën kërcënimin e përmbarrimit me dhunë. E pandehura detyrohet që me kryerjen e pagesës së dënimit me gjobë dhe shpenzimet e procedurës, për këtë të njoftoi gjykatën.

Arsy etimi

Sipas kërkesës së Agjencionit kundër korrupsionit me seli në Prishtinë, nr.01-3649/2012 prej ditës 11.10.2012, është filluar procedura e kundërvajtjes kundër pandehurit Sencar Karamuço nga Prizreni, për shkak kundërvajtjes nga nen. 9 dhe 15. par.3 e dënueshme sipas nen.17 par.1.pik.5 të Ligjit mbi deklarimin, prejardhjen dhe kontrollën e pasuris zyrtarëve të lartë publik, dhe deklarata mbi prejardhjen dhe kontrollën e dhuratave për të gjithë personat zyrtar (Z.04/L-050).

I pandehuri në mbrojtjen e vetë ka theksuar që si drejtor i Drejtoratit për raste urgjente dhe sigurim pranë KK Prizren, formularin e plotësuar mbi pasurin Agjencionit Kosovar kundër korrupsionit ka dorëzuar në afat dhe atë më 30.03.2012, por nga ana e tyre është vërtetuar që e njëjta nuk është i plotë dhe nga tij me kërkesë kërkuan që në afat prej 15 ditëve nga dita e pranimit të lajmërimit të kryej plotësimin e njëjtës. Kërkesën e përmendur Departamenti i shërbimeve publike pranë KK Prizren pranoi më 13.09.2012, në kohën kur ai ka qenë në pushimin vjetor në Turqi, si dhe pasë kthimit të tij nga pushimi, për këtë e lajmëruan me vonesë d.m.th.më 07.10.2012. Deklaroi edhe këtë, që menjëhere ditën e nesërme më 08.10.2012, me email, më vonë formularin e plotësuar dërgoi Agjencionit kundër korrupsionit, dhe njëkohësisht krahas tjerave kërkoi edhe ndjesë për shkak vonesës, me arsyetimin për shkak së të cilës ka ardhur deri këtu, si dhe nuk ka pasur të njohur që sipas ligjit është i detyruar në formularin mbi pasurin të paraqes edhe shtëpin familjare, e cila udhëhiqet në emër të babait të tij Fevziut, si dhe të hyrat cilat i realizon si menagjer në firmën “Anka ShPK” me seli në rr.Eqrem Çabej në Prizren, në shumën mujore prej 400 €.

Me shiqimin në provat e parashtruara nga ana e pandehurit është vërtetuar se më 08.10.2010 Agjencionit kundër korrupsionit me email më vonë ka dërgue formularin mbi pasurin, dhe njëkohsisht kërkoi ndjesë për shkak vonesës, me arsyetimin se në atë kohë ka qenë në pushim, e me shiqimin në formular mbi deklaratën pasuris është vërtetuar se i pandehuri në të njëjtën ka paraqitur edhe shtëpin familjare e cila gjendet në rr.Alajdin Berisha, nr.27 në Prizren, në vlerë prej 80.000 (tetëdhjetmijë) €, dhe njëkohsisht paraqiti edhe mjetet në të holla në shumën mujore prej 400 €, clën si menagjer pranon prej firmës „Anka ShPK“ në Prizren.

Me shiqimin në aktvendimin e lëshuar nga ana e Komunës së Prizrenit më 27.08.2012 është vërtetuar që i pandehuri Sencar Karamuço në periudhën prej 13.09.2012 deri më 17.09.2012 ka qenë në pushim vjetor.

Duke vlerësuar deklaratën e pandehurit dhe me shiqimin në provat të cilat gjenden në shkresat e lëndës është vërtetuar se i pandehura ka kryer kundërvajtjen e cila me kërkesë i vihet në barrë, për shkak së cilës është shpallur fajtor dhe dënuar sipas ligjit, me atë që me rastin e vendosjes mbi lartësin e dënimit janë marrë parasysh rrethanat rrënduese dhe lehtësuese nga nen.7, me atë që si rrethanë lehtësuese janë marrë parasysh që menjëhere, pasi iu është komunikue, Agjencionit për korrupsion paraqiti më vonë formularin e plotësuar mbi pronësin dhe njëkohsisht kërkoi edhe ndjesë nga ata për shkak

vonesës, që në kohën kur iu është dorëzuar kërkesa më vonë është gjendur në pushimin vjetor në Turqi, dhe se menjëherë, e pasi që me ardhjen nga pushimi kjo iu është komunikue, Agjencionit kundër korrupsionit paraqiti më vonë formularin e plotësuar mbi pasurin dhe njëkosisht kërkoi ndjesë nga ata për shkak të vonesës, dhe se në kohën kur kërkesa më vonë është dorëzuar është gjendur në pushimin vjetor në Turqi, dhe menjëherë, e pas ardhjes nga pushimi kjo iu është komunikue, Agjencionit kundër korrupsionit më vonë paraqiti formularin e plotësuar dhe njëkosisht kërkoi ndjesë nga ata për shkak të vonesës, dhe mu për këtë me zbatimin e nen.9 par.1 pik.1 të Ligjit mbi kundërvajtjet, dënimi me gjobë është zbutur, me bindje se me atë do të arrihet efekti dhe qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi shumën paushalle është marrë në bazë të nen.109 par.2 të LK-ës

Nga gjitha të paraqiturat është vendosur si në shqiptimin e aktvendimit.

**GJYKATA THEMELORE-DEPARTAMENTI PËRGJITHSHËM
DIVIZIONI PËR KUNDËRVAJTJE
Nr.903/05-2012**

Përkthyesi gjyqësor,
Kenan Hadri



Gjyqtari,
Alija Fazlji, d.v.

UDHËZIMI JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi mund të deponohet ankesa Gjykatës së Apelacionit-Departamentit të përgjithshëm - seksioni për kundërvajtje në Prishtinë, në afat prej 8 ditëve, nga dita e pranimit këtij aktvendimi. Ankesa parashtrohet përmes kësaj gjykate pa pagesë takse.